



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Nr. _____ Prot.

Datë 15.05.2009

V E N D I M

Nr.112 Datë 15.05.2009

Për
kërkim të dhënash nga Shoqëria “Albania AirLine MAK Shpk”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- | | |
|----------------------------|------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ Zt. Lush Perpali | Zv/kryetar |
| ▪ Znj. Servete Gruda | Anëtar |
| ▪ Zt. Koço Broka | Anëtar |
| ▪ Znj. Rezana Konomi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 15.05.2009, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Kërkim i të dhënave nga Shoqëria Albania AirLines MAK Shpk.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti neni 33 “Detyrimi për të njoftuar” .

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe informacionit të Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregut në lidhje me procedurën e kontrollit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Albania AirLine MAK Shpk. nga shoqëria Advanced Construction Group shpk, e cila është hapur me Vendim të Komisionit të Konkurrencës Nr. 100, datë 03.02.2009.

V È R E N S E:

- Me shkresën Nr. 485/6 Prot, datë 04.02.2009, shoqëria Albania AirLines MAK Shpk është njoftuar në lidhje me hapjen e procedurës së kontrollit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet “Shitblerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Albania AirLine MAK Shpk nga shoqëria Advanced Construction Group shpk”, me Vendimi të Komisionit Nr. 100, datë 03.02.2009,
- Me shkresën Nr. 485/7 Prot, datë 24.03.2009, Sekretariati i ka bërë me dije shoqërinë Albania AirLines MAK Shpk, penalitetet që rrjedhin nga mospërmbushja e këtij detyrimi ligjor.
- Në përfundim, mos-sigurimi i informacionit nga ana e shoqërisë Albania AirLines MAK Shpk. është bërë pengesë për vazhdimin e procedurës së kontrollit të këtij përqendrimi.
- Nëse të dhënat jepen jo të sakta, jo të plota ose jashtë afatit kohor mund të merret masa e gjobës deri në 1 % të xhiros totale të vitit paraardhës financiar sipas nenit 73 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2005 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 germa d) dhe nenit 33, shkronja 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

1. T’i kërkojë Shoqërisë Albania AirLines MAK Shpk, plotësimin e formularit të njoftimit të përqendrimit sipas udhëzimit mbi formën e njoftimit të përqendrimit (bashkëlidhur këtij vendimi, formulari dhe udhëzimi), brenda 15 ditësh nga data e njoftimit.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Perpali

Servete Gruda

Koço Broka

Rezana Konomi

(_____)
Zv/Kryetar

(_____)
Anëtar

(_____)
Anëtar

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R